

"PA BARRIERA", java e Aftesisë së Kufizuar

FSHDPAK me mbështetjen e Komitetit Suedez të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut organizoi më 21.11.2005 javën e aftesisë së kufizuar "Pa barriera", me qëllim ndergjegjesimin e aktoreve përgjegjës për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar, donatoreve dhe komunitetit me gjere në vendin tone

5

"Një enderr që nuk kisha patur guximin ta enderroja"

Përmes tregimeve të tyre, personat me aftësi të kufizuar bëjnë me dije opinionin shqiptar për vështirësitë që ata kanë kaluar dhe kalojnë duke u përballur me faktorët objektive dhe subjektive të shoqërisë shqiptare e në të njëjtën kohë apelojnë për domosdoshmerinë dhe nevojën e tyre për tu përfshirë në shoqëri si të gjithë

7

Ligji "Për ndihmë dhe shërbime shoqërore", nr. 9355 datë 10.03.2005 të rehat dhe problematikat në këndvështrimin ligjor

Ligji "Për ndihmë dhe shërbime shoqërore" Mars 2005 (neni 4/ pika 3) ka zgjeruar rrethin e përfshirjes duke përfshirë në skemën e pagesës të aftësisë të kufizuar edhe kategorinë e personave të cilëve AK nuk u ka ardhur vetëm sipasojë e lindjes apo për shkak të tjera deri në moshën 21 vjeç (apo deri 24 vjeç kur vazhdojnë shkollën e lartë) por ka përfshirë edhe kategorinë e PAK, të cilët janë bërë të tilië, për shkak të cilat nuk lidhen me punësimin.

9



3 Dhjetori – Dita e Kombeve të Bashkuara

për Aftësinë e Kufizuar në vemëndjen

ndërkombëtare dhe në realitetin shqiptar 3

Qeverite duhet të marrin përgjegjësitë e tyre dhe Ne duhet të bashkëpunojmë, të ngremë ura mirëkuptimi nëse duam që rezultatet të jenë të qëndrueshme dhe afatgjata.

“PA BARRIERA”, java e Aftësisë së Kufizuar 5

FSHDPAK me mbështetjen e Komitetit Suedez të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut organizoi me 21.11.2005 javën e aftësisë së kufizuar “ Pa barriera „ me qëllim ndërgjegjesimin e aktoreve përgjegjes për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar, donatoreve dhe komunitetit me gjere ne vendin tone

“Nje enderr qe nuk kisha patur guximin ta enderroja” 7

Përmes tregimeve të tyre, personat me aftësi të kufizuar bëjnë me dije opinionin shqiptar për vështirësitë që ata kanë kaluar dhe kalojnë duke u përballur me faktorët objektive dhe subjektive të shoqërisë shqiptare e në të njëjtën kohë apelojnë për domosdoshmerine dhe nevojën e tyre për tu përfshirë në shoqëri si të gjithë

P Ë R M B A J T J A

Ligji “Për ndihmë dhe shërbime shoqërore”,

nr. 9355 datë 10.03.2005 të rejtat dhe

problematikat në këndvështrimin ligjor 9

Ligji “Për ndihmë dhe shërbime shoqërore” Mars 2005 (neni 4/pika 3) ka zgjeruar rrethin e përfituesve duke përfshirë në skemën e pagesës të aftësisë të kufizuar edhe kategorinë e personave të cilëve AK nuk u ka ardhur vetëm sipasojë e lindjes apo për shkak të tjera deri në moshën 21 vjeç (apo deri 24 vjeç kur vazhdojnë shkollën e lartë) por ka përfshirë edhe kategorinë e PAK, të cilët janë bërë të tillë, për shkak të cilat nuk lidhen me punësimin.

VODAFONE mbështet integrimin e personave

me aftësi të kufizuar në Shqipëri 11

Zbatimi i këtij projekti do të mundësojë prodhimin e 30 karrikeve me rrota për 30 persona me aftësi të kufizuar në rajonin e Laçit e të Lezhës. Ky projekt realizon objektiva themelore integrimi për personat me aftësi të kufizuar në mbrojtje dhe respektim të të drejtave të tyre

Mevluti, sa shumë luftë për të shkuar në shkollë 13

Historia e Mevlutit është mëse e trishtë, por babai dhe gjyshërit e tij kanë vendosur që jeta gri e të voglit të mos bëhet fare e zezë. Dhe janë kapur pas një shprese: të paktën djali të shkojë në shkollë

Familja, fëmijët me nevoja të vecanta

dhe aftësimi i tyre për jetën 16

Zakonisht, në programet edukative apo shkollore për fëmijët apo të rinj me aftësi të kufizuar vihet theksi më shumë në elementet e zhvillimit dhe më pak në ato të aftësimin të tyre për jetën. Është e domosdoshme që kësaj të fundit t'i kushtohet më shumë rëndësi duke punuar me plane, qoftë edhe të vecanta.

Format dhe metodat bashkekohore në punën

me talentet e reja 19

...mentalitetet sipas të cilit personat e verber mund të jenë vetëm muzikante të mirë është gabim dhe sjell për të gjithë në probleme të mëdha. Dhuntitë e tyre janë një lloj si tek të gjithë njerezit e tjere. Eksperienat e ndryshme e kanë treguar këte. Ata kanë

thesarin e paçmuar: INTELIGJENCEN, prandaj detyra e të gjithëve është t’ju krijohet mundësia të gjejnë dhe të shpalosin vehten sipas aftësive dhe jo t’ju vihen kufizime

Të gjithë personat me aftësi të kufizuara

do të kenë një status 21

Zëvendësministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Kastriot Sulka: Jemi në proces pune, por duhet lobing

Dhurata për Krishtlindje 23

Si të gatujmë receta të reja 24

Revistë e përtremuajshme

Financuar nga:
Komiteti Suedez i Helsinkit
për të Drejtat e Njeriut

Swedish Helsinki Committee
for Human Rights

Fondacioni Shqiptar për të
Drejtat e Personave me
Aftësi të Kufizuar

Bashkëpunëtorë:

Bardhylka Kospiri
Narbis Ballhysa
Entila Zyba
Desdemona Harjeti
Elda Blea (Spaho_)
Brikena Demiras
Virxhil Nano
Instituti i nxënësve që nuk
shikojnë, Tiranë

Design
Orest Muça

Adresa:
Rruga: “Mujo Ulqinaku”
Nr.26 Tiranë

Tel.Fax:
++355 4 266892

E-mail: adrf@icc.al.eu.org
www.adrf.org.al

3 Dhjetori – Dita e Kombeve të Bashkuara për Aftësinë e Kufizuar në vëmëndjen ndërkombëtare dhe në realitetin shqiptar

SFIDA 20



kufizuar janë të diskriminuara në shumë aspekte. Sipas UNESCO-s një në gjashtë gra me AK ka mundësi të arsimohet, ndërsa martesë për to është një tabu.

Duhet të kemi parasysh që aftësia e kufizuar është një program serioz jo vetëm për të drejtat e njeriut dhe zhvillimin, por për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare.

Intelektualisht, moralisht dhe shoqërisht, është e gabuar të përjashtosh dhjetë përqind të popullsisë botërore nga gjithpërfshirja në jetën politike, ekonomike e sociale. Nëqoftëse shoqëria do të lerë jashtë procesit të edukimit e punësimit fëmijë, të rinj e gra me aftësi të kufizuara, ata do të mbeten ekonomikisht një barrë në process orteku për të.

Le të hedhim një sy në zyrat e institucioneve qeveritare, OJF dhe sektorit privat. A funksionojnë programet për aftësinë e kufizuar? Sa të përshtatura janë këto zyra dhe sa informacion të përshtatur ofrojnë për aftësinë e kufizuar? Sa PAK janë të punësuar në to? A ka PAK në pozicione



Dymbëdhjetë vjet më parë Asambleja e Përgjithëshme e Kombeve të Bashkuara (UN) e deklaroi 3 Dhjetorin si Ditën Ndërkombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuar. Kjo finalizoi iniciativat e hershme të UN për të ndërgjegjësuar komunitetin ndërkombëtar, për të njohur dhe përfshirë personat me aftësi të kufizuar në të gjitha sferat e jetës. Këto iniciativa përfshinë, por pa u kufizuar vetëm në to, Vitin Ndërkombëtar të Aftësisë së Kufizuar, Dekadën e UN për Personat me Aftësi të Kufizuar që u finalizua me Programin Botëror për Veprim për PAK (1992) dhe Rregullat Standarte të UN për Barazinë e Mundësive për PAK (1993).

milion PAK në të gjithë botën. Ajo gjithashtu synon të krijojë ndërgjegjësim rreth problemeve të tyre me këndvështrim të krijimit të modeleve konkrete, nëpërmjet programeve komunitare, kombëtare e ndërkombëtare, për t'u dhënë PAK një mënyrë të re jetese.

Personat me aftësi të kufizuar vuajnë dallimet nga përjashtimi dhe diskriminimi në shoqëri, por edhe brenda familjeve të tyre. Ata rrallë shkojnë në shkollë, sepse shpesh prindërit mendojnë se është investim i kotë, ose edhe se drejtuesit e shkollave bëhen pengesë. Gratë me aftësi të

Përse kjo ditë tërheq vëmëndjen ndërkombëtare?

Kjo ditë duhet të mobilizojë botën për vëmëndje më serioze në lidhje me nevojat, shqetësimet dhe aspiratat e më shumë se 600

Qeveritë duhet të marrin përgjegjësitë e tyre

dhe Ne duhet të bashkëpunojmë, të ngremë

ura mirëkuptimi nëse duam që rezultatet të

jenë të qëndrueshme dhe afatgjata.

vendimarrëse? A janë PAK të dukshëm në programet e tyre?

Fatkeqësisht politikat ende nuk janë gjithpërfshirëse, programet ende jo të plota dhe shërbimet ende të pamjaftueshme.

Të mos harrojmë për asnjë çast se mungesa e shpresës, diskriminimi, përjashtimi dhe varfëria ekstreme që karakterizojnë situatën dhe jetesën e pjesës më të madhe të personave me aftësi të kufizuar në vendet në zhvillim, është një element dhe mjet i fuqishëm për protesta dhe kaos. Ish presidenti francez Mitteran ka thënë: "Nëqoftëse ne jetojmë me iluzionin se ne mund ta bëjmë këtë botë të banueshme për një pakicë njerëzish, ne e bejmë atë të pabanueshme për të gjithë sëbashku".

Në këtë ditë përkujtimore, qeveritë në të gjithë botën deklarojnë të gjitha premtimet e mundëshme dhe PAK dëgjojnë duke menduar se kaloi edhe ky vit dhe vitin e ardhshëm do të dëgjojnë përsëri të njejtat

"Çdo gjë për Ne, me Ne " le të jetë motoja

jonë gjithpërfshirëse, drejt një shoqërie që

do të shembë muret e veçimit duke ofruar

akses për të gjithë anëtarët e saj.

premtime. Le të mos lejojmë që folësit t'i harrojnë këto premtime sapo të zbesin nga podiumi.

Përkujtimi i kësaj dite ndërkombëtare në Shqipëri, këtë vit, u shtri në periudhën kohore të të gjithë Dhjetorit : U parapri me një javë ndërgjegjëse për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar në fushën e legjislacionit, shërbimeve, arsimimit dhe përshtatshmërisë ndërtimore, e organizuar nga Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave

**Fatkeqësisht
politikat ende
nuk janë
gjithpërfshirëse,
programet ende jo
të plota dhe
shërbimet ende të
pamjaftueshme**

me Aftësi të Kufizuar dhe që u finalizua, pikërisht në Ditën Ndërkombëtare, me ceremoninë e promovimit të një libri të thjeshtë, por shumë domethënës, me histori eksperiencash dhe përpjekjesh të PAK në luftën e tyre individuale, të përditëshme, për integrim, të realizuar me mbështetjen e USAID – Shqipëri; u ndërthur me shumë aktivitete të grupimeve të aftësisë së kufizuar – shfaqje e protesta dhe u mbyll me ceremoninë e mrekullueshme të celebrimit të martesës të dy të rinjve me aftësi të kufizuar. Në të gjithë këtë larmi aktiviteteesh nuk mungoi vëmendja dhe pjesëmarrja e përfaqësuesve të qeverisë dhe në mënyrë të veçantë e kryeministrit Sali Berisha. Hapat e para të punës së Qeverisë së re, vendimet e marra dhe sfidat në vazhdim, në lidhje me problematikën e AK, janë shumë premtuese dhe nxitëse për bashkëpunim.

Qeveritë duhet të marrin përgjegjësitë e tyre dhe Ne duhet të bashkëpunojmë, të ngremë ura mirëkuptimi nëse duam që rezultatet të jenë të qëndrueshme dhe afatgjata.

"Çdo gjë për Ne, me Ne " le të jetë motoja jonë gjithpërfshirëse, drejt një shoqërie që do të shembë muret e veçimit duke ofruar akses për të gjithë anëtarët e saj.

Bardhylka Kospiri

Koordinatorë e Programit të
Avokatise pranë FSHDPAK





"PA BARRIERA", JAVA E AFTESISË SE KUFIZUAR

Me qëllim ndergjegjesimin e aktoreve përgjegjes për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar, donatoreve dhe komunitetit me gjere ne vendin tone, FSHDPAK me mbështetjen e Komitetit Suedez të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut organizoi me 21.11.2005 javën e aftësisë së kufizuar "Pa barriera",.

Zhvillimi i një aktiviteti të tillë mundësoi evidentimin e problematikës së aftësisë së kufizuar mbështetur edhe në objektivat themelore të Strategjisë Kombëtare për Aftësi të Kufizuar të tilla si: legjislacioni, arsimi, shëndetësia, shërbimet sociale dhe përshtatshmëria duke tërhequr vëmendjen për nevojën të zbatueshmërisë së politikave dhe kuadrit ligjor për respektim të të drejtave të personave me aftësi

te kufizuar.

Kjo javë u zhvillua në Tiranë dhe në 5 qytete të tjera të vendit, si: Vlorë, Shkoder, Durrës, Elbasan dhe Korçë. Çdo ditë e kësaj javë iu kushtua një problematikë të caktuar për aftësi të kufizuar;

1. Legjislacioni;

"Legjislacion gjithpërfshirës dhe mosdiskriminues edhe për personat me aftësi të kufizuar!"

2. Përshtatshmëria;

"Të projektosh ambiente të bukura është kënaqësi, të projektosh ambiente të përshtatura është dinjitet! "

3. Arsimi;

"Në të njëjtat shkolla me ose pa aftësi të kufizuar! "

4. Shëndetësia;

"Shërbime shëndetësore të garantuara për njerezit me aftësi të kufizuar! "

SFIDA 20

FSHDP
FONDACIONI
SHQIPTAR
PËR TË DREJTAT E
PERSONAVE ME
AFTËSI TË KUFIZUAR

LEGJISLACIONI

"Legjislacion gjithpërfshirës dhe mosdiskriminues edhe për personat me aftësi të kufizuar!"

PËRSHTATSHMERIA

"Të projektosh ambiente të bukura është kënaqësi, të projektosh ambiente të përshtatura është dinjitet!"

ARSIMI

"Në të njëjtat shkolla me ose pa aftësi të kufizuar!"

SHËNDETËSIA

"Shërbime shëndetësore të garantuara për njerezit me aftësi të kufizuar!"

SHERBIMET MBËSHTETËSE

"Me shumë alternativa shërbimesh për njerezit me aftësi të kufizuar!"

5. Sherbimet mbeshtetese;
"Me shume alternativa
sherbimesh per njerezit me aftesi
te kufizuar!"

Theniet shoqeruese te seciles
prej problematikave permbledhin
mesazhin qe u dha permes
aktivitetit te zhvilluar si dhe
materialeve dhe botimeve te
shumta ne funksion te seciles fushe
te siperpermendur.

Aktivitetet u zhvilluan me
pjesmarren e stafit te FSHDPAK,
studente vullnetare, aktive per
aktivitete te tilla te FSHDPAK si
dhe indvide me aftesi te kufizuar.

Aktiviteti i çdo dite u realizua
prane institucioneve te cilat jane
pergjegjese per zbatimin e
politikave dhe sherbimeve si dhe
per ofrimin e tyre.

Pjesmarresit ne aktivitete te
veshur me simbolet e javes
shperndane per perfaqesuesit e
ketyre institucioneve si;
deputeteve te Kuvendit te

**FSHDPAK me mbeshtetjen e Komitetit
uedez te Helsinkit per te Drejtat e Njeriut
lançoi me 21.11.2005 javen e aftesise se
kufizuar " Pa barriera „ me qellim
ndergjegjesimin e aktoreve pergjegjese per
respektimin dhe mbrojtjen e te drejtave te
personave me aftesi te kufizuar, donatoreve
dhe komunitetit me gjere ne vendin tone**



Shqiperise, stafit drejtues,
personelit mjekesor, te semureve
e familjareve te tyre, studente te
mjeksise prane QSUT; pedagoge
e studente te Fakultetit te
Ndertimit, mesues dhe nxenes te
shkollave te mesme te
pergjithshme materiale

informuese per zbatimin dhe
respektimin e te drejtave te
personave me aftesi te kufizuar ne
Shqiperi. Te njejtat aktivitete u
zhvilluan edhe ne 5 qytetet e tjera
prane institucioneve lokale,
pergjegjese per problematiken e
aftesise se kufizuar.

Gjithashtu kjo jave u pasyrua
gjeresisht ne masmedia permes
kronikave te shumta dhe artikujve
te shkruar nga gazetarë te trainuar
prane FSHDPAK per problematiken
e aftesise se kufizuar.

Rezultatet e aktiviteve te tilla
ndergjegjesuese deshmojne
rendesine dhe domosdoshmerine
e informimit te drejte te
strukturave pergjegjese dhe
opinionit ne pergjithesi per
problematiken e aftesise se
kufizuar duke rritur interesin e te
gjithe shoqerise per respektimin e
te drejtave te personave me aftesi
te kufizuar.

Narbis Ballhysa
Koordinatorë Programi

Rezultatet e aktiviteve te tilla

ndergjegjesuese deshmojne rendesine dhe

domosdoshmerine e informimit te drejte

te strukturave pergjegjese dhe opinionit

per problematiken e aftesise se kufizuar

duke rritur interesin e te gjithe shoqerise

per respektimin e te drejtave te personave

me aftesi te kufizuar.

Liber i historive jetesore te njerezve me

aftesi te kufizuar dhe familjareve te tyre

SFIDA 20

FSHDP
FONDACIONI
SHQIPTAR
PER TE DREJTAT E
PERSONAVE ME
AFTESI TE KUFIZUAR



"NJE ENDERR QE NUK KISHA PATUR GUXIMIN TA ENDERROJA"

Nga data 21.11.2005 deri me 25.11.2005, FSHDPAK mbeshtetur nga Komiteti Suedez i Helsinkit per te Drejtat e Njeriut organizoi ne Tirane dhe ne 5 qytete te tjera te vendit jave n afteise se kufizuar "Pa barriera", me qellim ndergjegjesimin e strukturave shtetore pergegjes per problematiken e afteise se kufizuar, donatoreve dhe komunitetit me gjere per mbrojtjen, respektimin dhe zbatimin e te drejtave te personave me aftesi te kufizuar ne Shqiperi. Gjate diteve te kesaj jave jane zhvilluar nje sere aktivitetesh kushtuar

çeshtjeve te tilla si, legjislacioni, arsimi, shendetesia, sherbimet sociale dhe pershtatshmeria duke mundesuar informim te aktoreve pergegjes dhe

opinionit publik permes materialeve e botimeve te shumta.

Kjo jave kulmoi me 1 Dhjetor me promovimin e botimit te ri, " Nje enderr qe nuk kisha patur guximin ta enderroja", liber me histori jetesore te personave me aftesi te kufizuar dhe familjareve te tyre. Botimi i tij eshte bere i mundur me mbeshtetjen financiare qe USAID ofron per FSHDPAK permes projektit "Sherbime mbeshtetese per personat me aftesi te kufizuar ne nevojte per karrike me rrota"

Ne liber jane perfshire histori jetesore te PAK, treguar nga vete ata, prinder, familjare apo miq te tyre. Libri vjen per lexuesin shqiptar si nje risi, duke ndergjegjesuar opinionin publik per problematiken e afteise se kufizuar nga nje kendveshtrim ndryshe dhe artistik ne te njejten kohe. Permes tregimeve te tyre, personat me aftesi te kufizuar bejne me dije opinionin shqiptar per veshtiresite qe ata kane kaluar dhe kalojne duke u



perballur me faktoret objektive dhe subjektive te shoqerise shqiptare e ne te njejten kohe apelojne per domosdoshmerine dhe nevojën e tyre per tu perfshire ne shoqeri si te gjithë.

Ne kete ceremoni nderuan me pjesmarrjen e tyre perfaqesues te larte te Ministrise se Punes, Çeshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta, Ministrise se Shendetesise, Ministrise se Arsimit, donatore, partnere dhe bashkepunetore te FSHDPAK.

Prezenca e Z. Steve ZATE Zv. Ambasador i SHBA ne Shqiperi, perfaqesues te USAID ne Shqiperi, si dhe pershendetja e veçante e Tij ne kete aktivitet deshmuar edhe njehere mbeshtetjen qe qeveria e SHBA dhe populli amerikan permes USAID jane duke ofruar ne vijimesi per personat me aftesi te kufizuar ne Shqiperi.

Edhe njehere ne kete ceremoni Ministri i Punes dhe



Permes tregimeve te tyre, personat me aftesi te kufizuar bejne me dije opinionin shqiptar per veshtiresite qe ata kane kaluar dhe kalojne duke u perballur me faktoret objektive dhe subjektive te shoqerise shqiptare e ne te njejten kohe apelojne per domosdoshmerine dhe nevojën e tyre per tu perfshire ne shoqeri si te gjithë

Çeshtjeve Sociale Z. Kosta Barka, ne fjalen e tij theksoi angazhimin e Qeverise Shqiptare per zbatimin e

politikave sociale dhe legjislationit ne mbeshtetje te drejtave te personave me aftesi te kufizuar ne Shqiperi.

Ky aktivitet sherbeu gjithashtu per te konstatuar serish faktin se ne perpjekjet tona per te hedhur hapa te ndjeshem ne permiresimin cilesor te kushteve integruese te PAK ne shoqerine shqiptare, jane bashkuar dhe kontribuojne shume institucione shqiptare shtetore e private si dhe donatore te huaj ne Shqiperi.

Ne perfundim te ceremonise te pranishmit u ftuan te blejne kete liber per te kontribuar ne ngritjen e nje fondi i cili iu dhurua ne prag te Krishtlindjes shoqates per femije me aftesi te kufizuar mendore ne Shkoder.



Ligji "Për ndihmë dhe shërbime shoqërore", nr. 9355 datë 10.03.2005 të rejat dhe problematikat në këndvështrimin ligjor

SFIDA 20

FSHDP
FONDACIONI
SHQIPTAR
PER TE DREJTAT E
PERSONAVE ME
AFTESI TE KUFIZUAR

Parlamenti i Republikës së Shqipërisë, në datë 10.03.2005, ka miratuar Ligjin nr. 9355 "Për ndihmë dhe shërbime shoqërore", ligji i cili ka për qëllim të përcaktojë ndihmën dhe shërbimet shoqërore për individët dhe grupet në nevojë, të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike, për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara ekonomike, fizike, psikologjike dhe shoqërore.

Ky ligj, ka shfuqizuar ligjin nr. 7710 datë 18.05.1993 "Për ndihmë dhe përkujdesje shoqërore" (i ndryshuar), dhe ka parashikuar në dispozitat e tij elementë të rinj në ndihmë të PAK, por gjithësesi edhe në këtë ligj ndihen ende "nota diskriminuese" midis kategorive

të personave me aftësi të kufizuar për sa i përket përfitimit ekonomik.

Më poshtë po shpjegojmë hollësisht disa nga elementët e rinj të sanksionuar në ligjin "Për ndihmë dhe shërbime shoqërore" Mars 2005, në këndvështrim krahasues me ligjin e mëparshëm:

- Ligji "Për ndihmë dhe shërbime shoqërore" Mars 2005 (neni 4/ pika 3) ka zgjeruar rrethin e përfituesve duke përfshirë në skemën e pagesës të aftësisë të kufizuar edhe kategorinë e personave të cilëve AK nuk u ka ardhur vetëm sipasojë e lindjes apo për shkaqe të tjera deri në moshën 21 vjeç (apo deri 24 vjeç kur vazhdojnë shkollën e

lartë) por ka përfshirë edhe kategorinë e PAK, të cilët janë bërë të tillë, për shkaqe të cilat nuk lidhen me punësimin.

Pikërisht këtu përfshihen një numër i madh prej tyre, të cilët janë ende të paidentifikur për shkak se ata nuk mund të përfitonin si nga ligji i mëparshëm "Për ndihmë dhe përkujdesje shoqërore" ashtu edhe nga sistemi i sigurimeve shoqërore.

Në këtë kategori përfshihen shumë individë të cilëve ju është kufizuar aftësia për të vepruar për shkaqe nga më të ndryshmet, shëndetësore, aksidente rrugore, aksidente në punë (të cilët nuk kanë derdhur kontribute në skemën e sigurimeve shoqërore, kanë punuar në "punë të zezë"), si pasojë e trazirave të vitit 1997, apo raste të individëve të emigruar jashtë Shqipërisë të

Programi në "Radio Tirana"



Në vazhdim të objektivave të tij Programi "Avokati dhe Asistencë ligjore për PAK", për ti ardhur sa më shumë në ndihmë PAK dhe familjarëve të tyre, ka filluar që prej Shtatorit 2005, në kanalin e parë të Radio Tiranës, transmetimin 2 herë në javë, në intervalin kohor 11:00-12:00, emisioni "Ligji sa e njohim dhe sa e zbatojmë atë". Avokatja e Programit Ligjor pranë FSHDPAK gjatë intervistës në studio shpjegon ligjet e sferës së aftësisë të kufizuar të cilat veprojnë në RSH por njëkohësisht ofron konsulencë ligjore telefonatave direkte të telefonuesve nga qytete të ndryshme të Shqipërisë, ku nuk kanë munguar edhe telefonata të emigrantëve nga Italia, Greqia, Franca apo Anglia.

cilët për shkaqe nga më të ndryshmet u është kufizuar aftësia. Ka një numër të madh rastesh të cilat janë identifikuar nga Programin Ligjor pranë FSHDPAK, me anë të të cilit ofrohet çdo ditë konsulencë ligjore dhe Avokat, falas, për të gjithë PAK dhe familjarët e tyre (për çështje që lidhen me aftësinë e kufizuar).

- Përfitues të pagesë të aftësisë të kufizuar, të cilët do të trajtohen nga ky ligj, janë edhe kategoritë e PAK (të verbërit) me mungesë të plotë apo të pjesshme shikimi, të lindur apo të fituar, **para dhe tetraplegjikët**, të caktuar me vendim të KMCAP, pavarësisht nga shkaku dhe mosha dhe **invalidët e punës** që përfitojnë pension invaliditeti dhe shtesë mujore mbi të sipas statusit të invalidit të punës. Në këtë kontekst, është për tu përsëritur përfshirja edhe e kategorive të tjera të PAK, megjithatë nuk do të lëmë pa theksuar se ende me këtë ligj, edhe pse nuk ka shumë muaj që është miratuar, përsëri vërehet se PAK intelektuale (me aftësi të kufizuar mendore) mbeten ende të diskriminuar midis kategorive të tjera (pavarësisht nga mosha) si në aspektin ekonomik, mungesa e statusit përkatës për këtë

kategori (përfitimet që ofrojnë statute të ndryshme të PAK) ashtu edhe në aspektin e parimit të gjithëpërfshirjes.

- Sipas këtij Ligji, të gjithë përfituesit e pagesës të aftësisë të kufizuar, të cilët me vendim të komisione të posaçme mjeksore, përcaktohet se ka nevojë për përkujdesje,

e drejta e aplikuesit, të cilit i refuzohet kërkesa për përfitimin e pagesës të aftësisë të kufizuar ose të shërbimit shoqëror me vendim të këshillit të njësisë të qeverisjes vendore, **ka të drejtë ta ankimoj këtë vendim në gjykatë.** Ndërkohë që kjo e drejtë nuk ishte e parashikuar në ligjin e

mëparshëm "Për ndihmë dhe përkujdesje shoqërore" dhe jo në pak raste PAK që pretendonin të përfitonin pagesën e aftësisë të kufizuar ndodheshin përballë mjeteve të kufizuara

Ligji "Për ndihmë dhe shërbime shoqërore" Mars 2005 (neni 4/pika 3) ka zgjeruar rrethin e përfituesve duke përfshirë në skemën e pagesës të aftësisë të kufizuar edhe kategorinë e personave të cilëve AK nuk u ka ardhur vetëm sipasojë e lindjes apo për shkaqe të tjera deri në moshën 21 vjeç (apo deri 24 vjeç kur vazhdojnë shkollën e lartë) por ka përfshirë edhe kategorinë e PAK, të cilët janë bërë të tillë, për shkaqe të cilat nuk lidhen me punësimin.

përfitojnë edhe kujdestar me pagesë. Në këtë mënyrë është hequr kufizimi i kaq viteve me rradhë, ku të drejtën për të përfituar përkujdesje me pagesë e kishin vetëm PAK të cilët ishin pjesëtar të një familjeje e cila përfitonte pagesë nga ndihma ekonomike (ishin pjesë e skemës ekonomike).

- Miratimi i këtij ligji ka shfuqizuar edhe nenin 2 të ligjit nr. 8626 datë 22.06.2000 "Për Statusin e Invalidit Para dhe Tetra plegjik", gjë që na lë të nënkuptojmë që aktet nënligjore të cilat do të pasojnë në vazhdim të mund ta zgjerojnë rrethin e përfituesve të statusit të invalidit para dhe tetraplegjik. Por fjalën e fundit edhe në këtë rast e kanë aktet nënligjore përkatëse.
- Për herë të parë në Ligjin "Për Ndihmë dhe shërbime Shoqërore", Mars 2005, në nenin 25 të tij është përcaktuar

ligjore për mbrojtjen e të drejtave të tyre.

Së fundi nuk do të lëmë pa përmendur një element shumë të rëndësishëm, sa ligjor edhe konkret, pikërisht zbatueshmërinë e këtij ligji. Ligji "Për Ndihmë dhe shërbime Shoqërore" është miratuar në datë 10.03.2005. Në nenin 45 përcaktohet se ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në fletoren zyrtare. Deri tani asnjë nga aktet nënligjore për zbatim të tij nuk janë miratuar nga instancat kompetente. Kjo ka bërë që një numër i madh personash me aftësi të kufizuar të cilët përfitojnë me ndryshimet e reja të presin me ankth zbatimin e këtij ligji, por ndërkohë çdo ditë pranë zyrrave të FSHDPAK janë paraqitur ankesat e shumta nga PAK apo familjarë të tyre të cilëve moszbatimi në kohë i ligjit ju ka shtuar edhe më tej problemet e tyre.

Entila Zyba

Avokate, koordinatorë programi



VODAFONE

mbeshtet integrimin e personave me aftesi te kufizuar ne Shqiperi

Fondacioni VODAFONE permes VODAFONE - Shqiperi mbeshtet serish gjate vitit 2005, Fondacionin Shqiptar per te Drejtat e Personave me Aftesi te Kufizuar per mundesimin e vazhdimetise se projektit te prodhimit te mjeteve levizese, karrike me rrota per personat me aftesi te kufizuar ne Shqiperi.

Ne nentor 2005 ndermjet FSHDPAK perfaqesuar nga Znj. Blerta Cani dhe VODAFONE - Shqiperi perfaqesuar nga Z. Thomas Papaspyrou firmoset kontrata per zbatimin e projektit per pajisjen me karrike me rrota te prodhuara ne punishten

“Miresia” te 30 personave me aftesi te kufizuar.

Aplikimi i ketij projekti realizon objektiva themelore integrimi per personat me aftesi te kufizuar ne

mbrojtje dhe respektim te te drejtave te tyre si:

1. **Te drejten per punesim;** Prodhimi i mjeteve levizese realizohet nga punonjes me aftesi te kufizuar ne punishten “ Miresia”, program i FSHDPAK i vetem i ketij lloji ne Shqiperi. Ky angazhim i krijon atyre mundesi te drejtperdrejta per integrim ne jete permes punes duke ndikuar ndjeshem ne permiresimin e kushteve social ekonomike per ta dhe familjet e tyre. Financimi i projekteve te tilla me qellim



nxitjen e punesimit per personat me aftesi te kufizuar eshte tregues i ndergjegjesimit te komunitetit te donatoreve per krijimin e hapësirave reale te integritimit per ta duke ridimensionuar shoqerine shqiptare drejt nje shoqerie qe nuk kufizon respektimin e te drejtave te njeriut.

2. Te drejten per sherbime mbeshtetese; Pajisja e personave me aftesi te kufizuar me mjete levizese, karrike me rrota eshte nje parakusht per integrimin e tyre ne shoqeri. Keto mjete u ofrojne PAK shanse per te shmangur izolimin dhe per tu perfshire aktivisht ne aktivitetet sociale dhe kulturore qe komuniteti ku ata jetojne ofron per te gjithë.

Sic edhe mund te vleresohet financimi i vazhdueshem qe VODAFONE eshte duke ofruar per nje projekt te tille ndihmon ne qendrueshmerine e modeleve te verteta integruese per personat me aftesi te kufizuar ne Shqiperi.

Zbatimi i ketij projekti do te mundesoje prodhimin e 30 karrikeve me rrota per 30 persona me aftesi te kufizuar ne rajonin e

Zbatimi i ketij projekti do te mundesoje

prodhimin e 30 karrikeve me rrota per

30 persona me aftesi te kufizuar ne

rajonin e Laçit e te Lezhës. Ky projekt

realizon objektiva themelore integrimi

per personat me aftesi te kufizuar ne

mbrojtje dhe respektim te te drejtave te

tyre si: te drejten per punesim dhe te

drejten per sherbime mbeshtetese



Laçit e te Lezhës. Keta persona jane PAK ne nevoje per mjete levizese te identifikuar si te tille nga zyrtat e ndihmes dhe sherbimeve sociale ne nivel lokal me te cilat FSHDPAK bashkepunon

ngushtesisht per identifikimin e nevojave per sherbime te personave me aftesi te kufizuar.

Nevojat per mjete levizese jane ne rritje si pasoje e faktoreve te ndryshem, perfshire semundjet, aksidentet, mungesat ne identifikim etj. FSHDPAK nga informacioni zyrtar i ofruar prej Zyrrave Rajonale ne 6 rajone te vendit rezultojne 1000 PAK ne nevoje per mjete levizese.

Angazhimi i kompanive te rendesishme si VODAFONE ne mbeshtetje te projekteve te tilla eshte siguri per me shume shanse ne jete per personat me aftesi te kufizuar.



MEVLUTI

Sa shumë luftë për të shkuar në shkollë

Kjo nuk është vetëm historia e Mevlut Nokës, një 9-vjeçari që, përveç gjumit në krevat, gjithë pjesën e ditës e kalon mbi një karrike me rrota. Në Tiranë fatin e tij të keq dhe të njëjtën sëmundje e kanë të paktën edhe 10 fëmijë të tjerë, me shifra, e kushedi sa të tjerë, që ende nuk janë rregjistruar. Kurse në Shqipëri, ata janë me dhjetëra. Historia e Mevlutit është mëse e trishtë, por babai dhe gjyshërit e tij kanë vendosur që jeta gri e të voglit të mos bëhet fare e zezë. Dhe janë kapur pas një shprese: të paktën djali të shkojë në shkollë. Shpresë që rrezikon të vdesë që prej 4 muajsh, kur Mevluti nuk mundi të fillojë dot klasën e tretë. Familja nuk e përballonte më pagesën e 2 000 lekëve të reja në muaj, për ta dërguar në një shkollë private.

*

* *

Kur ai lindi, 9 vjet të shkuara në Kukës, çiftit Noka nuk i shkonte

ndërmend se fëmija i tyre i parë do të zinte karriken pas ca vitesh. S'do të kalonte shumë kohë që prindërit të kuptonin se Mevluti vuante nga një lloj i veçantë i distrofisë muskulare, një sëmundje e trashëgueshme e cila prek vetëm pasardhësit meshkuj. Sikur Mevluti të kishte lindur vajzë... tani do të ecte me këmbët e veta. "Është një

sëmundje e çuditshme, që prek vetëm të lindurit meshkuj. Në Tiranë, sipas

shifrave tona, ka të paktën 10 fëmijë të sëmurë me distrofi muskulare. Besojmë se ka të tjerë, sepse njerëzve nuk u pëlqen t'i bëjnë publike problemet e fëmijëve të tyre", - thotë Entila Zybo, juristja pranë Fondacionit Shqiptar të të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara (FSHDPK), fondacion që ka marrë përsipër të bëjë avokatinë e të drejtës së shkollimit për Mevlutin.

Fëmijën nuk mundëm ta takonim dot sepse familja e tij i druhet efektit që mund të ketë tek i vogli biseda me gazetarë, shkrepet e aparatit fotografik. As gjyshi i të voglit, kreu i mbetur në shtëpi pas ikjes së babait të Mevlutit në Greqi, nuk ka dëshirë të flasë e të kujtojë një histori që i ka tronditur krejt jetën, kështu që gjithçka e mori përripër ta tregonte FSHDPK,



sigurisht me miratimin e Nokajve.

Ky lloj i distrofisë muskulare nuk ka edhe aq shenja të dukshme në fillim. Por pasi mbush ca vite jetë, i vogli fillon të lodhet shumë nga e ecura. Ai këputet mbi dysheme ndërsa është në këmbë sepse këto të fundit nuk e mbajnë dot më. Janë shumë të dobëta.

Sikur të mos mjaftonte sëmundja e Mevlutit, çiftit Noka u lind një fëmijë tjetër mashkull, me të njëjtin gen ogurzi të trashëguar. Vëllai i Mevlutit sot është 6 vjeç dhe ka të njëjtat shenja. Ai bie papritur përtokë teksa është duke ecur, pa mundur të hedhë shumë hapa.

Ka edhe më. Radha i vjen një fatkeqësie tjetër, të lloji tjetër. Nëna e të vegjëlve i braktis, ata dhe burrin e saj, pa pranuar t'u qëndrojnë më pranë. Që prej asaj dite, dy të vegjlit u rritën nga i ati dhe dy prindërit e tij të moshuar. Derisa ai vendosi të zbrësë nga Kukësi në kryeqytet për një jetë më të mirë, me shpresën se në qytetin e madh të bijtë do të kishin ndonjë mundësi. Para 4-5 vjetësh, burri ngriti një shtëpi dykatëshe diku në një lagje periferike të Qytetit Studenti në Tiranë e më pas u martua. Sot me gruan e dytë ka edhe një vajzë e cila, për fatin e saj të mirë, nuk rrezikohet nga distrofia muskulare e këtij lloji, që prek vetëm meshkujt.

*

* *

Me dy prindër të moshuar, me tre fëmijë të vegjël, dy prej të cilëve të sëmurë e me një grua të papunë, babait të Mevlutit iu desh të ikte nga Shqipëria. Në Tiranë

Historia e Mevlutit është mëse e

trishtë, por babai dhe gjyshërit e tij

kanë vendosur që jeta gri e të voglit të

mos bëhet fare e zezë. Dhe janë kapur

pas një shprese: të paktën djali të

shkojë në shkollë

me të punuarat lart e poshtë pa siguri, pa një punë të qëndrueshme, s'mund të ushqente dot veten dhe 6 gojë të tjera. Ai ndodhet tashmë në Greqi dhe familja, përveç atyre 10 000 lekëve të reja që marrin vëllezërit e vegjël si asistencë për sëmundjen e tyre, jeton vetëm me ato që

dërgon babai emigrant.

Historia e Mevlutit ndoshta kurrë nuk do të ishte marrë vesh sikur ai të mos ishte rregjistruar në një kamp për fëmijët me aftësi të kufizuara, që u organizua nga FSHDPAK në Durrës, këtë shtator. "Ishin duke biseduar me fëmijët kur Mevluti na tregoi se këtë vit nuk shkonte dot në shkollë", - tregon Zyba e cila shton se më pas shkoi në shtëpinë e tij për të marrë vesh gjithçka. "Familja e Mevlutit jeton në kushte shumë të vështira, në katin e dytë të shtëpisë së papërfunduar, në një zonë informale. Dy vjet e gjysmë më parë, pas një marrëveshje që kishte bëri gjyshi me drejtorin e një shkolle private, ky i fundit kishte pranuar që ta rregjistronte fëmijën me 20 mijë lekë të vjetra në muaj, në një kohë që të tjerëve u merrte 10 mijë. Mevluti kreu në këtë shkollë klasën e parë dhe të dytë e gjatë kësaj kohe furgoni i saj e merrte dhe e sillte në shtëpi. Kurse këtë vit kushtet ekonomike të familjes u rënduan shumë dhe ata nuk mund ta përballonin pagesën e shkollës private", - tregon Zybo.

Të ardhur nga një rreth i largët e pa babain pranë që të interesohej për djemtë e sëmurë, Nokajt nuk ia kishin edhe aq idenë ligjeve, nuk e dinin se shteti, në rastet kur fëmija nuk mund të shkojë në shkollë, duhet t'i japë atij arsimin e detyrueshëm. Nuk

ÇFARË THOTË LIGJI

Dispozita normative për arsimin parauniversitar

Neni 57

Largimet e nxënësve

Pika 15

Nxënësit me aftësi të kufizuara, mbështetur në kërkesën me shkrim të prindërve dhe pas një konsultimi me personelin e mësuesve, mund të largohet nga shkolla në çdo kohë, kur gjykohej se ata nuk përfitojnë nga këto institucione apo kur të tjera forma apo mundësi më efikase ekzistojnë.

Pika 16

Personeli mësimor edukativ bën përpjekje që nxënësit me aftësi të kufizuara të mos largohen nga shkolla. Në rast se ata largohen, sipas parashikimit të pikës 15, arsimimi i tyre mund të vijojë në shtëpi nëse prindi e dëshiron një gjë të tillë. Arsimimi në shtëpi kryhet edhe për ata nxënës që mungojnë në shkollë për periudha të gjata. Mësuesit që do të konsultojnë nxënësit në shtëpi, sipas mundësive që ka shkolla speciale, lehtësohen nga ndonjë detyrë tjetër ose caktohen mësues që nuk kanë plotësuar ngarkesën mësimore javore.

e dinin derisa FSHDPAK u tha se kjo ishte një e drejtë që Mevlutit nuk mund t'i hiqej asesi. Dhe kështu filluan përpjekjet e pafundme për të gjetur një zgjidhje me Drejtorinë Rajonale Arsimore të Tiranës (DART).

*

* *

"Së pari dua të sqaroj se nuk i takon vetëm prindërve të rregjistrojnë fëmijët e tyre në shkollë. Sipas ligjit, drejtoritë arsimore, për kontigjentet e nxënësve të rinj, marrin informacion edhe në zyrat e përkrahjes sociale pranë bashkive ose komunave. Lista e tyre u bëhet e njohur drejtorëve të shkollave",- thotë Zybo e cila këmbëngul se Mevluti nuk duhej të ishte lënë pa shkollë nga drejtoria arsimore, edhe nëse familja e tij nuk e rregjistroi në ndonjë shkollë. Juristja pastaj lexon pika të tjera të nenit 57 të dispozitave normative për arsimin parauniversitar që e mbështesin të drejtën e Mevlutit për t'u shkolluar, pavarësisht kushteve të tij fizike.

"Në muajin nëntor i dërguam një kërkesë DART ku e njohëm me rastin dhe ajo propozoi që Mevluti të dërgohej në shkollën më të afërt me shtëpinë e tij, "Osman Myderizi". Por shtëpia është gjithsesi goxha larg, Mevluti është me karrocë me rrota, rrugët janë të paasfaltuara dhe gjyshi i tij, i vetmi burrë që ka mbetur në shtëpi, nuk ka aq forcë sa ta sjellë fëmijën në shkollë. Drejtoria na tha se familja e Mevlutit duhet ta zgjidhë vetë çështjen e transportit, por në të vërtetë ata nuk kanë asnjë mundësi",-thotë Zybo.

Sipas saj ekziston një hapësirë tjetër ligjore që i garanton Mevlutit arsimimin e detyruar. "Sipas ligjit, shteti mund të dërgojë një mësues në shtëpinë e fëmijës me aftësi të kufizuara. Aq më shumë, në këtë

rast do t'i bëhej mirë edhe vëllait 6-vjeçar të Mevlutit, që po jep shenjat e paralizimit e që, njëkohësisht, është edhe në moshë për të nisur klasën e parë. Gjithsesi, shumë mirë do të ishte edhe sikur shteti të sigurojë transportin e tij e ta çonte në shkollë, në mënyrë që Mevluti të rrinte me fëmijët e tjerë, të mos mbetej vetëm brenda katër mureve, me të vëllain dhe motrën".

*

* *

Në 21 dhjetor, përgjegjësjë e sektorit të kualifikim-trajnimit në DART, Zamira Gjini, tha se ishin studiuar të gjitha mundësitë e arsimimit për Mevlutin. "Historia e të cilit më preku shumë",-shtoi ajo. Pasi ka dështuar përpjekja për ta çuar tek Osman Myderizi, Gjini pati zhvilluar një bisedë me drejtorin e shkollës për të parë nëse kishte ndonjë mundësi që djalit të mitur t'i dërgohej në shtëpi ndonjë nga mësuesit. "Ai zhvilloi një mbledhje me ta, por nuk ishte e mundur që ndonjëri ta merrte përsipër arsimimin e Mevlutit. Klasat e tyre kanë nga 40 nxënës dhe ata i kishin të plotësuar orët e mësimit".

SFIDA 20

FSHP
FONDACIONI
SHQIPTAR
PËR TË DREJTAT E
PERSONAVE ME
AFTESI TË KUFIZUAR

Kur nga "Osman Myderizi erdhi sinjali përfundimtar se nuk kishin si ta ndihmonin Mevlutin 9-vjeçar, Gjini provoi të fliste me një tjetër drejtoreshë, atë të shkollës speciale për fëmijët me aftësi të kufizuara në Tiranë, "Luigj Gurakuqi". "Por edhe kjo drejtoreshë e kishte të pamundur t'i dërgonte Mevlutit në shtëpi ndonjë mësues sepse ata të gjithë i kishin plotësuar orët e punës. Vetë shkolla ndërkaq është specializuar më tepër për fëmijët me aftësi të kufizuara mendore, kurse Mevlut Noka ka probleme fizike. Kështu që unë mendoj se më e mira e tij është që të përfitojë nga projekti "Shansi i dytë". Atij do t'i dërgohet 2 herë në shtëpi një nga 6 mësuesit e lënë në dispozicion të këtij projekti, jam më shumë se 90% e sigurt për këtë. Më mbetet të caktoj vetëm emrin e mësuesit",-premtoi Zamira Gjini.

Elda Blea (Spaho)

Gazetare, gazeta "Shekulli"





Një ndër detyrat më të rëndësishme që shtrohet për fëmijët me nevoja të vecanta është ajo e aftësisimit të tyre për jetën. Edhe puna që bëhet në shkolla speciale, shkollat e zakonshme apo në qendra të ndryshme riaftësimi nuk do të kishte kuptim nëse ajo do të shihej e shkëputur nga përgatitja e këtyre fëmijëve dhe të rinjve për t'i bërë ballë kërkesave të jetës, për të hyrë në marrëdhënie me të tjerët, për të qenë të pavarur, pse jo edhe produktiv.

Shpesh prindërit mendojnë se nëse këta fëmijë do mësojnë të lexojnë apo të shkruajnë, kjo do të thoshte se ata "do të shëroheshin", do të bëheshin njëlloj si të tjerët. Ky konceptim është i gabuar sepse ka gjëra të tjera shumë më të rëndësishme në jetë që sigurojnë normalizimin dhe integrimin e tyre në jetën e përditshme. Në aftësimin e tyre gjithmonë e më shpesh ka dalë ne pah vlera dhe domosdoshmëria e përgatitjes së personave me aftësi të kufizuara në një pikëpamje sa më praktike. Kjo do të thotë që gjithçka që bëhet të shihet në sensin se sa do ti vlejnjë për jetën njohuritë dhe shprehitë që ne u mësojmë atyre, sa funksionale do të jenë ato për të bërë një jetë dinjitoze.

Zakonisht prindërit i pyesin fëmijët e tyre kur janë të vegjël: "Cfarë dëshiron të bëhesh kur të rritesh?". Ndërkohë, prindërit që kanë fëmijë me nevoja të vecanta as nuk guxojnë të shtrojnë një pyetje të tillë. Por ky qëndrim nuk është i drejtë. Është e nevojshme dhe e domosdoshme që një pyetje e tillë të shtrohet sa më shpesh dhe të punohet në këtë drejtim gradualisht që edhe ata të gjejnë

një vend të denjë në jetë.

Prindërit dhe edukatorët e tyre vazhdimisht duhet të shtrojnë pyetjen: "Cfarë duhet të bëjmë që djali apo vajza jonë të mund të jetojë, të luajë, të punojë, të argëtohet, të mësojë sa më shumë të jetë e mundur në mënyrë të pavarur?". Edhe koha që ata kalojnë në shkolla apo qendra të ndryshme duhet parë nga vlera që ajo ka që këta fëmijë mbas kësaj periudhe të mund të vazhdojnë dhe të jetojnë si gjithë të tjerët, të punojnë sipas mundësive, të shplohden, të argëtohen etj. Zakonisht, në programet edukative apo shkollore me këta fëmijë apo të rinj vihet theksi më shumë në elementet e zhvillimit dhe më pak në ato të aftësisimit të tyre për jetën. Është e domosdoshme që kësaj të fundit ti kushtohet më shumë rëndësi duke punuar me plane, qoftë edhe të vecanta.

Përvoja botërore dhe ajo shqiptare tashmë ka ofruar shembuj të shumtë të natyrave të ndryshme që dëshmojnë se vullneti dhe këmbëngulja, bashkëpunimi midis prindërve, fëmijëve, dhe profesionistëve bën që këta persona të thyejnë rekorde të pa imagjinuara.

Sido që ti quajmë këto plane: "të aftësisimit për jetën", "të

përgatitjes praktike", "të tranzicionit për të qenë të pavarur" etj., ato duhet të nisin sa më herët. Edukimi dhe arsimimi i personave me aftësi të kufizuara duhet të jetë sa më praktik dhe funksional.

Duhet të kuptohet se ky formim nuk mund të realizohet vecmas nga prindërit apo edukatorët. Kërkohej që ata të bashkëpunojnë duke marrë parasysh nevojat specifike të çdo fëmije dhe pa harruar realitetin ku duam ti integrojmë.

Ndër shprehitë e rëndësishme që duhet t'u formojmë këtyre të rinjve përmendim:

a. Shprehitë më të domosdoshme të ekonomisë shtëpiake: si të vetshërbehen, të hanë, të gatujnë, si të shtrojnë tavolinën, të përdorin mjetet dhe enët e kuzhinës, si të kujdesen për shtëpinë dhe të vendosin gjërat në vendet e duhura, si të përkujdesen për vetveten dhe për shëndetin e tyre, si të gatujnë, si të ndjekin rutinat e zakonshme të jetës në mënyrë të pavarur, si të pastrojnë, lajnë dhe marrin pluhurat etj.

b. Shprehitë shoqërore: si të lozin dhe jetojnë me të tjerët, t'i përgjigjen buzëqeshjes me buzëqeshje, si të luajnë, si të vendosin kontakte me sy, si të shprehin nevojat dhe ndjenjat e

tyre, si ti mbrojnë gjërat e tyre dhe të luajnë me të tjerët pa krijuar shqetësime, si të ndihmojnë në punët e shtëpisë, si të dallojnë dhe mbrohen nga keqbërësit, si të vendosin dhe ruajnë marrëdhënie me shok e shoqe, si të shmangin sjelljet problematike (qëndrimin indiferent, futjen e gjërave në gojë, shpërthimet dhe zemërimet e tyre, sjelljet jo të pëlqyeshme në shoqëri, izolimin dhe shqetësimin vend e pa vend të të tjerëve etj.), si të tregojnë nevojat dhe preferencat e tyre, si të argëtohen në grup duke mësuar nga sjelljet e të tjerëve, si të mbajnë radhën në lojë dhe në situata të tjera shoqërore, si të tolerojnë shtrëngimet apo frustacionet që mund ti ndodhin, si të tolerojnë dhe pranojnë kritikën, si të përshtaten me kërkesat e grupit, si të vendosin marrëdhënie me bashkëmoshatarët dhe të rriturit duke mbajtur një qëndrim korrekt të trupit, tonit të zërit etj., si të kërkojnë në mënyrë korrekte informacione apo ndihmë nga një i rritur, e shumë e shumë të tjera.

c. Shprehinë integruese: kemi parasysh në këtë kuadër zhvillimin tek këta të rinj të aftësive për t'u orientuar dhe njohur gjërat më kryesore në ambjentet ku jetojnë, si të orientohen në ambjente të panjohura dhe në mjedisin ku jetojnë. Në këtë kuadër me vlerë janë aftësitë që ata duhet të zhvillojnë për të qënë qytetar dhe këmbësor të rregullt: të ecin në mënyrë të pavarur dhe të sigurtë në ambjentet publike, të gjejnë vendin e drejtë ku duhet kaluar rruga, të kontrollojnë dhe të ruhen nga automjetet duke kaluar kohën e duhur tek semafori, të sillen mirë me të panjohurit gjatë lëvizjeve në

qytet. Po kështu ata duhet të aftësohen dhe në përdorimin e mjeteve të transportit publik: si të ndjekin procedurat që përdorin të gjithë qytetarët, si të kenë sjellje dinjitoze në automjet, të zbesin në stacionin që duhet etj. Gjithashtu, të vlefshme janë shprehinë që ata duhet të kenë për të përdorur shërbimet e ndryshme që ofron komuniteti (dyqanet e ndryshme, klubet, ambulancën, farmacinë etj.).

Në kuadrin e shprehive integruese që duhet t'i formojmë këtyrë të rinjve vlerë të madhe kanë edhe shprehinë e përdorimit të lekëve, njohja e orës, përdorimi i telefonit, dhe elemente të tjerë praktikë të jetës.

Në të gjitha sa përmendëm më lart nuk duhet të harrojmë kursesi se metoda më e mirë për t'i mësuar këta të rinj është **modeli që ne u ofrojmë atyre.**

Në kuadrin e formimit të tyre për jetën, i një rëndësie të veçantë është zhvillimi i aftësive që ata të komunikojnë sa më mirë me të tjerët. Në këtë kuadër kemi parasysh t'u zhvillojmë atyre **aftësitë e komunikimit:** si të flasin, si të dëgjojnë, si të komunikojnë me shkrim, pse jo edhe të lexojnë. Ndokush mund të thotë se këto janë të vështira, por jeta ka treguar se shumë elemente të leximit, shkrimit, të folurit, të dëgjimit mund të mësohen në mënyrë praktike. Ata duhet të aftësohen të thonë emrin e tyre, datëlindjen e tyre, të emërtojnë dhe të formojnë fjali qoftë edhe të thjeshta, të mësojnë të përgjigjen në telefon, të përdorin fraza funksionale, të pyesin thjeshtë dhe qartë, të flasin duke e parë tjetrin në sy, ti transmetojnë

SFIDA 20



një mesazh dikujt, të dëgjojnë deri në fund një person që flet, të realizojnë dy a më shumë porosi etj.

Nga sa më sipër, nuk pretendojmë se ezauruam të gjitha shprehinë që ata mund të zhvillojnë. Është karakteristik fakti se këta fëmijë dhe të rinj e kanë të vështirë zakonisht të transferojnë një shprehinë të mësuar nga një ambjent në një tjetër, prandaj kërkohet që ata të ushtrohen në rrethana sa më të larmishme, të mësohen të lëvizin në ambjente që nuk janë të përgatitura posacërisht për ta, të jetojnë sa më shumë me fëmijë dhe të rinj të tjerë. Shpesh paaftësia e tyre për të kryer dicka apo për të punuar vjen nga mungesa e përvojës që ata kanë për **punë të vërtetë**. Prandaj është e domosdoshme që këta fëmijë dhe të rinj të angazhohen në mënyrë të organizuar sa më shumë në veprimtari praktike.

Prindërit në bashkëpunim me mësuesit dhe edukatorët duhet të interesohen sa më herët për perspektivën që duhet të kenë këta fëmijë:

- Cfarë punë mund të bëjë fëmija im në të ardhmen?
- Si dhe ku do të jetojë ai kur unë nuk do të jem më?
- Cfarë shprehish i nevojiten atij?
- Sa i përgatitur është ai për një jetë të pavarur?
- Cfarë shokësh ka dhe cilët do të jenë miqtë e tij të ardhshëm?

Për të gjitha këto dhe të tjera, prindërit vet mund të gjejnë zgjidhje dhe zgjedhje të shumta duke u mbledhur dhe shkëmbyer mendime me njëri-tjetrin.

Një nënë e suksesshme në një takim për shkëmbim përvojë, duke vënë re ndrojtjen apo frikën që përjetonin prindërit e këtyre

Zakonisht, në programet edukative apo shkollore për fëmijët apo të rinj me aftësi të kufizuar vihet theksi më shumë në elementet e zhvillimit dhe më pak në ato të aftësimin të tyre për jetën. Është e domosdoshme që kësaj të fundit ti kushtohet më shumë rëndësi duke punuar me plane, qoftë edhe të vecanta.

fëmijëve, ndër të tjera u shpreh: *"Mos humbni kohë, cdo gjë arrihet, nëse dëshiron të bësh dicka për fëmijën tënd fillo që tani... që ai të mësojë të bëj vet cdo gjë. Ne prindërit duhet të bëjmë një listë me pyetje dhe tu përgjigjemi atyre:*

- *Kush ja pret bukën, mishin...?*
- *Kush e vesh, e lan, e pastron?*
- *Kush zgjedh se çfarë duhet të vesh dhe ku duhet të shkojë?*
- *Kush e ndihmon të kalojë rrugën?*
- *Si vepron fëmija im me lekët?*
- *Si të takon dhe të jep dorën?*
- *Di ai të gatuajë një ushqim që i nevojitet?*
- *Ble ai vet në dyqan gjëra të ndryshme?*
- *Është në gjendje të dalë nga një situatë e vështirë në rast rreziku?*
- *Di të flasë në telefon, të marrë një porosi, apo të transmetojë një mendim?*
- *Di të laj rrobat vet, qoftë edhe me lavatrice?*
- *Di të mirëmbajë dhomën, të kërkojë ndihmë?*
- *Di të zgjedhë shokët, apo të ruhet nga rreziqet?*

Pra është e rëndësishme që për të gjitha sa më sipër të organizohen aktivitete praktike, jetësore.

Njëri nga vllazërit e familjes i thotë një herë i nxehur nënës së vet (lidhur me vëllanë e tij me nevoja të vecanta): *"Pse e vesh kështu? Apo do të duket që është me të meta."* Kjo tregon se vëllazërit e tyre, fëmijët e tjerë të së njëjtës moshë janë aleatët më të mirë të prindërve dhe mësuesve.

Këta fëmijë dhe të rinj duhet të jetojnë sa më shumë jashtë familjes, të marrin pjesë në aktivitete zbavitëse, në diskutime,

të shkojnë në stadium, kinema, të jenë pjesë e jetës së vërtetë, të kenë shokë dhe të zgjedhin shoqërinë që preferojnë.

Jo më kot thuhet: ***"Shkolla të mëson të lexosh dhe të shkruash, shokët të bëjnë të zgjuar"***.

Zakonisht, disa prindër mendojnë se fëmija nuk është i aftë ti bëj të gjitha veprimet dhe në shumicën e rasteve i kryen ai ato në vend të tij, duke harruar në këtë mënyrë se po e dëmton pa dashje fëmijën e vet duke e bërë të varur për gjithcka.

Një aspekt i rëndësishëm për jetën e tyre është përgatitja graduale për të kryer punë të ndryshme. Kjo bën që ata të ndjehen të vlefshëm dhe të rrisin vetbesimin. Krahas kësaj nuk duhet të neglizhojmë aftësimin gradual të tyre si të kalojnë kohën e lirë, si të dallojnë dashamirësit nga keqbërësit, si të kërkojnë ndihmë në situatë të ndryshme. Të gjitha këto dhe të tjera ndihmojnë në mirëqënien e tyre fizike dhe shpirtërore duke i bërë ata pjesë të integruar të jetës normale.

Nga sa më sipër rezulton se duhet të kemi më shumë besim tek këta fëmijë dhe të rinj. Shumë prindër punojnë mirë, por mjaft nga ata kanë frikë se mos humbasin fëmijën. Është normale të frikësohesh, por ***mos lejo që frika jote të bëhet pengesë për pavarësinë e fëmijës tënd***. Pavarësia do ta bëjë atë të rritur, nëse nuk duam që ata të mbeten gjithmonë "fëmijë të përjetshëm".

Fakte të shumta demonstrojnë se edhe nivelet e rënda të personave me nevoja të vecanta arrijnë të kenë jetën e tyre, të punësohen në procese të thjeshta,

të krijojnë edhe familje. Nëse ata stimulohen dhe ushtrohen gradualisht përgjatë gjithë jetës pa paragjykuar dhe pa neglizhuar asnjë fazë, këta persona edhe se pse me pak ndihmë arrijnë një pavarësi të atillë në gjendje për të kryer me përgjegjësi veprime dhe marrëdhënie që kërkon adoleshencia dhe më pas moshë e rritur.

Ajo që i pengon prindërit është më shumë frika ndaj rreziqeve. Kjo si edhe mendimi i tyre se kjo situatë nuk është kalimtare, bën që këta prindër në moshën e adoleshencës t'i tejmbrojnë të rinjtë duke i kontrolluar në cdo detaj të sjelljes së tyre. Kjo bën që nganjëherë këta të rinj të përballen pa prituri me situata tepër të vështira si: manifestime seksuale të ekzagjeruara etj., gjë që nuk ndodh në ato familje ku ka patur preokupim për të rritur gradualisht pavarësinë e fëmijës apo adoleshentit. Duke mos i dhënë të riut mundësi për të zhvilluar pavarësinë, prindi e mban atë artificialisht në një gjendje fëmimore dhe mbas ca kohe zgjohet dhe kupton se fëmija ka kaluar nga i vogël - direkt në plakje, duke i privuar kështu atij periudhën më të bukur të jetës.

Sigurisht, zgjidhje të parafabrikuara dhe cudibërëse për cdo rast nuk ka. Cdo familje duhet të përpiqet të gjejë një zgjidhje që pajton dhe balancon të drejtën e personit me aftësi të kufizuara për të rritur pavarësinë e tij me mundësinë për të ushtruar këtë pavarësi me përgjegjësi në atë shkallë që shoqëria e kërkon edhe për anëtarët e tjerë të saj.

Prof.As.Dr. Virxhil Nano





Format dhe metodat bashkekohore ne punen me talentet e reja

Puna me talentet e reja eshte nje pune sa e bukur aq edhe e veshtire. Them eshte nje pune e bukur sepse mendoj se ne qe punojme per zbulim dhe perpunimin e talenteve te reja , hap pas hapi ndejme kenaqesine e madhe qe kemi bere detyren tone si njerez , artiste dhe si mesues. Pra,nje femije te talentuar e kemi bere qe permes artit te tij iu jep te tjereve nje motiv me shume per te jetuar, duke mbushur shpirtin e tyre me me shume optimizem dhe dashuri per jeten.

Per te arritur ketu eshte nje udhe e gjate per t'u bere, plot me veshtiresi dhe lodhje,pse jo dhe me shume sakrifica. Ketu mesuesi ka nje rol primar dhe te pazevendesueshem.

Suksesi i tij varet nga format dhe metodat qe perdor ai gjate punes se tij. Se pari mendoj se gjeja kryesore qe duhet te kemi parasysh, eshte se talenti muzikor tek femija shfaqet ne forma dhe menyra te ndryshme , kjo

varesisht dhe nga tipi dhe vecoria e karakterit te secilit prej tyre. Keshtu qe mesuesi eshte i detyruar te kerkoje gjithmone forma dhe metoda te reja si per zbulimin dhe trajtimin e talenteve ne cdo stad.

Pas hapit te pare,zbulimit te talentit muzikor tek femija , vjen trajtimi ose puna me te.Kjo eshte nje rruge e mundimshme plot me ulje dhe ngritje ne te gjitha pikpamjet.

Ne kete kuptim mendoj qe mesuesi krahas punes

profesionale nuk duhet te harroje as aspektin psikologjik qe ze nje vend po aq paresor per te kapur suksesin.

Ne fillim femija mesimin e nje instrumenti e konsideron si loje, ndaj mesuesi me shume takt,duhet t'a beje ate qe veshtiresite e para te impostimi ne instrument t'i konsideroje si pergjegjes ndaj vehtes dhe porosite e mesuesit t'i kuptoje si detyra per te , si gjithë detyrat e tjera shkollore. Per te qene te sukseseshem ne kete hap te pare vendimtar, i cili na jep garanci per sukses me tej, duhet te kemi parasysh:

Femijes i duhet krijuar nje atmosfere e ngrohte, por nga ana tjetër vete ambjenti ku ai zhvillon mesimin duhet t'i krijojë atij pershtypjen qe ketu mesohet dhe jo luhet. Konkretisht ambjenti ku ai meson duhet te jete i ngrohte, i qete plot drite, i pa ngarkuar me sende qe largojne vemendjen e nxenesit nga mesimi. Mesuesi duhet t'a beje klasen nje vend ku nxenesi te gjeje frymezim per te punuar dhe njekohesisht te mos shkaktoje lodhje. Mesuesi gjate ores se mesimit nuk duhet

...mentalitetet sipas te cilit personat e verber mund te jene vetem muzikante te mire eshte gabim dhe sjell per te gjithë ne probleme te medha. Dhuntite e tyre jane nje lloj si tek te gjithë njerezit e tjere. Eksperienat e ndryshme e kane treguar kete. Ata kane thesarin e paçmuar: INTELIGJENCEN, prandaj detyra e te gjithëve eshte t'ju krijohet mundesia te gjejne dhe te shpalosin vehten sipas aftesive dhe jo t'ju vihen kufizime

t'i atribuojë vehtes rolin e një vëzhguesi strikt, por duke komunikuar qetë, qartë duke qendruar afër nxenesit edhe fizikisht si dhe duke i dhënë mundësi nxenesit të shprehë lirish gjatë studimit dhe duke u rikthyer në të dhe është e nevojshme, ka siguruar kështu një vijueshmeri normale të një ore mesimi. Krahas fjalës mesuesi duhet të demonstrojë duke luajtur vetë në instrument për t'i thënë nxenesit me emocion, bukur dhe thjeshtë atë që mund t' i thuash vetëm përmes tingujve.

Kur komunikojmë me nxenesin gjatë një ore mesimi duhet të kemi parasysh kompozitorin e madh Robert Shuman që n'a keshillon: "Asnjë femijë nuk rritet e behet njeri i shëndoshe me perkedheli embelsira e karamelë. Ushqimi i shpirtit, ashtu si ai i trupit, duhet të jetë i thjeshtë dhe i shëndetshëm. Mjeshtrit e medhenj janë kujdesur mjaft për një ushqim të tillë; përdore atë".

Synimi madhor i mesuesit duhet të jetë që me punën e tij t'a bëjë të vetdijshëm nxenesin për atë që bën në çdo hap. Ai duhet t'a binde nxenesin me idenë që të besh muzikë, nuk do të thotë vetëm që të mesosh nota të një partiture ose të artikulojë gishtat. Gjatë orës së mesimit mesuesi krahas shpjegimit të elementeve teknike për zoterimin e një instrumenti, duhet të flase edhe për kompozitorët, veprat e të cilit nxenesi luan, epokën kur jetuan, stilin e tyre të kompozimit, vendin që ka secili në zhvillimin e artit muzikor kombëtar e botëror etj...

Mesuesi duhet të bërë të ditur

nxenesit rendesinë që ka për të mesimi dhe përvetësimi i lendeve baze teorike muzikore si teori solfezhi, harmonia, polifonia etj. e ka çliruar atë përgjithmone nga diletantizmi dhe krenaria boshe.

Me mënyrën të ndryshme mesuesi duhet të zgjojë tek nxenesit e tij interesimin dhe dashurinë për muzikën popullore, sepse ky është një investim i madh për krijimin e individualitetit kombëtar tek artistët e rinj dhe me vone në përkurim artistik të tyre. Mendoj gjithashtu se asnjë artist i ri apo me përvojë nuk duhet të humbasin rastin kur është fjala për të parë një operë të bukur ose një koncert nga artistë të njohur apo nga artistë të rinj. Keto janë eksperiencat të tjera që i shërbejnë artistit për t'u njohur me sa më shumë të reja në fushën e ekzekutimit dhe interpretimit, si dhe është një shtytje dhe një frymëzim i ri në punën e tij në vazhdimësi.

Mesuesi duhet punuar gjithnjë me moton "Mesimi s'ka fund..." duhet t'i ndihmojë nxenesit të kuptojnë që është e domosdoshme njohja edhe me artet e tjera dhe fusha të ndryshme të shkencës. Kështu duke qenë gjithmone sa më i disponueshëm, është me të lehtë të besh muzikë me kombinimet e pafundme të shtatë notave, duke ngritur peshe shpirtin e degjuesve dhe duke e bërë vehtën

protagonist të sentencës "Artistët janë inxhinierë të shpirtërve njerezorë".

Arti në vetvete është krijimtari, ndaj format dhe metodat gjatë procesit të përgatitjes të artistëve të rinj janë të shumta dhe gjithmone në evoluim.

Pa dashur të jap recetë, por vetëm duke u mbështetur në përvojën time të punës në këtë fushë, dua të them se nësi mesues mund të shfrytëzojë të gjithë burimet e informacionit që për fatin tonë të mirë nuk janë pak për t'u pasuruar format dhe metoda tradicionale me të reja, me të fundit, sigurisht të përshtatshme për ne, në mënyrë që të garantojmë suksesin.

Së fundi dua të them se mentalitetet sipas të cilit personat e verber mund të jenë vetëm muzikantë të mirë është gabim dhe sjell për të gjithë në probleme të mëdha. Dhuntitë e tyre janë një lloj si tek të gjithë njerezit e tjerë. Eksperiencat e ndryshme kanë treguar këtë.

Ata kanë thesarin e paçmuar: INTELIGJENCEN prandaj detyra e të gjithëve është t'ju krijojë mundësia të gjejnë dhe të shpallin vehtën sipas aftësive dhe jo t'ju vihen kufizime.

Desdemona Horjeti

*Mesuese në "Instituti i nxenesve që nuk shikojnë",
Tiranë*





Zëvendësministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Kastriot Sulka: Jemi në proces pune, por duhet lobing

Të gjithë personat me aftësi të kufizuara do të kenë një status

Nëse një person me aftësi të kufizuar në shikim, apo në lëvizje gëzon një status të veçantë në Shqipëri, një fëmijë apo i rritur me aftësi të kufizuar mendore nuk ka status dhe nuk gëzon asnjë mbrojtje të veçantë nga ligjet shqiptare. Diskriminimi për këtë komunitet të vogël brenda komunitetit të personave me aftësi të kufizuara fillon që këtu. Dhe më pas shpërndahet në çdo shërbim tjetër, qoftë ky i detyrueshëm ose jo, siç është arsimimi, punësimi, shërbimet shoqërore dhe shëndetësore, kujdestaria apo edhe infrastruktura e përshtatshme. Po përse personat me aftësi të kufizuar mendore kanë mbetur pa status? Një pyetje, që sipas zëvendësministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, do të marrë së shpejti një përgjigje. "Është e vërtetë që këta persona kanë mbetur pa një status dhe neve na ka lindur kjo pyetje. Prandaj jemi duke punuar për të bërë një status të përgjithshëm PAK për të gjithë personat me aftësi të kufizuara", shprehet zëvendësministri i Punës Kastriot Sulka.

STRATEGJIA

Sipas zëvendësministrit, për të arritur në një status të përgjithshëm që të përfshijë të gjithë personat me aftësi të kufizuara, përfitimet dhe shërbimet e nevojshme për ta, do të duhet një lobing i përgjithshëm edhe me shoqërinë civile. "Kemi nisur edhe bisedimet me organizatat e specializuara që merren me fushën e paaftësisë dhe jemi duke punuar për këtë gjë", thekson zëvendësministri Sulka. Aktualisht, personat me aftësi të kufizuara mendore trajtohen vetëm në bazë të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore". Sipas nenit 7 të këtij ligji, përfitues të pagesës për aftësinë e kufizuar janë të verbrit, me mungesë të plotë ose të pjesshme të shikimit, të lindur ose të fituar, të cilët janë deklaruar të paaftë për punë me vendim të Komisionit Mjekësor të Përcaktimit të Verbërisë, paraplegjikët dhe tetraplegjikët, të cilët deklarohen me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë se janë bërë të tillë, pavarësisht nga shkaku dhe

mosha, si dhe personat me aftësi të kufizuar, të cilët deklarohen të paaftë për punë me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë. Gjithashtu, me pagesën e paaftësisë trajtohen edhe personat, të cilët janë deklaruar invalidë pune me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, që përfitojnë pension invaliditeti dhe shtesë mujore mbi të, sipas Statusit të Invalidit të Punës. Kështu, vihet re se ndërsa të gjithë këta persona përfitojnë edhe në bazë të statusit të tyre lehtësira të tjera, personat me aftësi të kufizuara mendore marrin vetëm një pagesë prej rreth 6 800 lekë në muaj. Gjithashtu, në bazë të nenit 8 të ligjit të mësipërm, personat përfitues, të cilët me vendim të komisioneve mjekësore të posaçme përcaktohen se kanë nevojë për përkujdesje, përfitojnë edhe një kujdestar me pagesë. Në praktikë, kujdestaria e personave me aftësi të kufizuar mendore jepet vetëm për ata që janë klasifikuar në kategorinë e parë dhe të dytë. Ndërsa ata që përfaqësohen në kategorinë e tretë, që është e një niveli më të lehtë, janë të përjashtuar, edhe pse specialistët e fushës mendojnë që të gjithë kanë nevojë për një kujdestar, që t'i ndihmojë në zhvillimin e një jete sa më normale.

SHERBIMET

Për personat me aftësi të kufizuara ofrohen shërbime ditore publike e jopublike në shumë qytete të vendit, por shërbimet ende janë të pamjaftueshme dhe afatshkurtra. Ky është vetëm një nga konkluzionet e Strategjisë për Shërbimet Sociale. Përvoja disavjegare dhe studimet e bëra për llojshmërinë e shërbimeve dhe gjeografinë e tyre kanë evidentuar grupet kryesore në nevojë, që janë të ekspozuar ndaj rrezikut. Një

ndër këto grupe janë fëmijët me aftësi të kufizuara. Në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe programet që zbatohet aktualisht për PAK, fëmijët e lindur me aftësi të kufizuara ose të bërë të tillë deri në moshën 21 vjeç, përfitojnë mbështetje me një pagesë për aftësinë e kufizuar në kesh, me qëllim që familja të përmbushë nevojat e veçanta të fëmijës. Por jo të gjithë përfitojnë nga kjo gjë. Gjithashtu, për të mbështetur dhe nxitur fëmijët me aftësi të kufizuara për t'u arsimuar, ato marrin 200 për qind të pagesës së aftësisë së kufizuar, në rastet kur vazhdon shkollën e mesme dhe 300 për qind të pagesës kur vazhdon shkollën e lartë. Por që të vazhdojnë shkollën e mesme apo të lartën këta fëmijë duhet në fillim të ndjekin arsimin e detyrueshëm. Nga ana tjetër, përfitohet edhe pagesa e kujdestarisë për ata persona që nuk mund të kujdesen për veten, sipas vendimit të KMCAP. Por akoma ka familje që diskriminohen dhe kujdestarinë për personat me aftësi të kufizuara nuk e marrin dot ata që kanë nevojë. Fëmijët me aftësi të kufizuara përfshihen në qendrat rezidenciale të zhvillimit, të cilat kanë ngritur njësi ditore për të përfshirë sa më shumë familjen në jetën e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Në vitin 2004, si PAK, janë trajtuar 56 mijë persona dhe rreth 32 mijë invalidë pune, të cilët kanë përfituar rreth 4,7 miliardë lekë.

ARSIMI GJITHËPËRFSHIRËS

Shteti në këtë pikë nuk ka bërë ende asgjë. Këtë e vërteton më së miri edhe fakti që nuk ka asnjë praktikë me anën e së cilës të identifikohen fëmijët që duhet të ndjekin këtë nivel arsimor. Edhe pse i detyrueshëm arsimi nëntëvjeçar nuk është i tillë për të gjithë fëmijët, sidomos për

fëmijët me aftësi të kufizuara mendore, të cilët nuk e gjejnë veten në asnjë shkollë normale. Në fakt, Ministria e Arsimit, ka menduar që të bëjë një identifikim të numrit të përgjithshëm të fëmijëve me aftësi të kufizuara që duhet të integrohen edhe në shkollat normale. Në kuadër të strategjisë së arsimit gjithëpërfshirës, parashikohet që nga ky dikaster të përfundonte një studim për të bërë një llogaritje të fëmijëve me aftësi të kufizuara që duhet të përfshiheshin në shkollat normale dhe të integroheshin së bashku me fëmijët e tjerë. Por studimi i nisur vitin e kaluar ka mbetur pezull për mungesë fondesh. Ministria e Arsimit është duke kërkuar donatorë të tjerë në mënyrë që të realizohet ky studim i nevojshëm. Sipas Fatmir Bezatit, specialist në drejtorinë e zhvillimit të kurrikulave, ky identifikim është shumë i nevojshëm dhe këtë vit mendohet të përfundojë realizimi i tij.

QENDRAT REHABILITUESE

Larg paragjykimeve dhe brenda komunitetit për të fituar atë që iu mungon. Kjo është ajo çka synohet për të rehabilituar njerëzit me aftësi të kufizuara. Por, personat që kanë pasur probleme të shëndetit mendor kanë shumë pas alternativa. Një prej tyre është shërbimi i specializuar në qendrën ditore "Alternativa", apo edhe në qendra të tjera ditore, si "Ndihmoni Jetën", "Pëllumbat", etj. Përfshirja në këto qendra varet nga mosha e personave me aftësi të kufizuara mendore, si dhe nga dëshira e tyre apo e familjarëve për t'i nxjerrë nga katër muret rrethuese të shtëpisë. Shumë prej tyre nuk kanë mundësi të bëhen pjesë e një komuniteti të tillë, sepse nuk e dinë ku të drejtohen. Shumë prej tyre nuk kanë një qendër të tillë, në afërsi të banesës dhe e kanë të pamundur të ndjekin programe rehabilitimi. Ajo që ofrohet në qendrat shtetërore të paaftësisë lë shumë për të dëshiruar për shkak edhe të stafit jo tërësisht të kualifikuar për t'u

marrë drejtpërdrejt me paaftësinë. Ndërsa në qendrat private, që financohen nga burime të ndryshme donatorësh të huaj përgjithësisht, mundësia për të marrë pjesë është e kufizuar. 35 persona me probleme të shëndetit mendor në qendrën "Alternativa" kryejnë punë të ndryshme praktike dhe krijuese, si në pikturë, por edhe në përgatitjen e qirinjve, apo punimet në qëndisje, duke i ekspozuar herë pas here. Ata janë të grupmoshës së rritur nga 25 deri në 50 vjeç. Rehabilitim nëpërmjet punës, vetëbesim dhe ndërgjegjësim për të rifituar aftësitë e tyre, është qëllimi i organizatorëve që merren me menaxhimin e saj. Të ardhurat që grumbullohen shpesh herë nga punimet e ekspozuara apo edhe nga shitja drejtpërdrejt e këtyre punimeve në qendër, përdoren për vazhdimësinë e këtij aktiviteti, që i ndihmon këta artistë të veçantë të ndihen njëloj me gjithë të tjerët, madje edhe shumë më tepër. E njëjta gjë ndodh edhe në qendër ditore "Ndihmoni Jetën", por aty trajtohen fëmijë nga 12 deri në moshën 22 vjeç. Aktivitetet kryesore janë kujdesi për higjienën vetjake, për mirëmbajtjen dhe gatimin në shtëpi, por edhe mësimi i kompjuterit dhe i punëve me dorë, si qëndisja për vajzat dhe ushtrime të tjera fizioterapie. Ky është edhe qëllimi i qendrës, t'i integrojë fëmijët me probleme mendore në shoqëri dhe t'i bëjë ata të denjë për veten, për familjet e tyre dhe për komunitetin ku jetojnë, që të mos ndihen të vetmuar, edhe kur dalin në rrugë. Aktualisht në këtë qendër trajtohen 30 fëmijë me aftësi të kufizuara, nga të cilët 18 në qendër dhe 20 në shtëpi.

Brikena Demiras
Gazetare, gazeta "Panorama"



DHURATA PER KRISHTLINDJE

(Sfide per "SFIDEN")

SFIDA 20

SHDP
FONDACIONI
SHQIPTAR
PER TE DREJTAT E
PERSONAVE ME
AFTESI TE KUFIZUAR

Futemi ne atmosferen e bukur te Krishtlindjeve, dhe vigjilja është aq hyjnore sa nuk gjenden fjale te zakonshme per ta pershkruar.

Fjale te zakonshme !!!

Jam futur e tëra në këtë atmosferë dhe me botën e madhe të internetit kapërcej kufijte e mundesive brenda vendit dhe bëhem pjesë e botës së madhe.

Ti lexues i SFIDES bashkoi me mua, mamin e dy femijeve te vegjel qe po rend ne kete atmosfere, te premtoj qe se bashku do sfidojme...

Kerkesat e femijve te mi:

Tedi: Nje ninxhe me emrin Leonardo

Krisi: Nje shoqe per Barbin

Kerkojme...

Dhe ja shfaqet sfida e re "BEKi".

Shoqja e re e Barbit vjen Beki kameramane e shkolles, por ne nje karroce me rrota.

"Perpjekja per ndryshim" nga MATTEL, disenjatori i kukullave me te bukura per femijet.

Barbi e hyjnyzuar per vite me rradhe per persosmerine tani i ngul kembet ne toke mes nesh dhe behet pjese e te ndryshmes qe na karakterizon te gjithëve, ashtu si Tereza me ngjyre , ashtu si Rosi e nje race tjetër, vjen Becky me këtë paaftesi fizike por po aq hyjnore sa dhe shoqet e saj , vjen me nje ndryshim, fizik , por ka nje veshje shume te bukur, ka nje kamere dhe nje detyre shoqerore te ngarkuar, ka dhe ka....

E gjeta dhuraten ky ishte goli i madh per vajzen time qe disa here me kish pyetur per Dorin se cfare mund te bente dhe pse ishte pak ndryshe.

(Dori eshte nje adoleshente me aftesi te kufizuara mike e familjes sime.)

Kur vajza ime e pa kete kukull u ndje pak konfuze. i shpjegova se kjo kukull është shoqe e Barbit dhe se ajo kerkonte pak ndihme prandaj i nevojitej karroca me rrota .Vajza ime u pergjigj "Oh i duhet



karroca te eci si shkronjat" , po i thashe dhe njerëzit mund te jene ne cfardo moshe dhe mund t'u nevojitet karroca. I shpjegova se kjo kukull qe është fotografja e shkolles mund te beje shume gjera qe mund t'i bejne kukullat Barbi, por qe nga karrikja me rrota. Gjithashtu i thashe se ajo ndoshta nje dite mund kete nje shoqe qe mund te kete nje paaftesi, por gjithashtu mund te jete shume gazmore si shoqet e saj.

Kjo kukull është një mësim i

madh për fëmijët e vegjël sepse është një moshë qe mbryhet , dhe mbillet perceptimi sesi ata te shikojne te gjithë njerëzit që i rrethojne ne bote.

Shume shpesh, shume femije l'a thone gjerat e rendesishme njeri – tjetrit vetem pse femija tjetër eshte i ndryshem

Vetë kukulla është një Barbi e cilësisë së lartë, me xhinse të vogla shumë të lezecme, atlete te kuqe, por kamera (është e vogël, kështu që duhet parë me imtësi). Përbërësi kryesor i kësaj kukulle është karrikja me rrota dhe duket mjaft qartë, dicka shumë e arrirë ndërsa ju u shpjegoni fëmijëve per njerëzit me paaftesi.

Vajza ime luan shumë me këtë kukull dhe kukullat e tjera Barbie, psh nihmojnë te shtyjne Bekin, ose nganjëre ajo thotë "Beki mund t'i jape vete karrikes".

Sic kam dëgjuar, kjo kukull nuk u pëlqen disa njerëzve, por ishte shumë c'dekurajuese për fëmijët, por ju gjithashtu mund ta ktheni në një dicka pozitive, nëse doni. Duke u mesuar fëmijëve, se ndryshimi ne pamjen e jashtme të një personi, nuk do të ndikojë në mënyren se si ato ndihen rreth një personi, ne mund të inkurajojmë fëmijët tanë të gëzojnë mirësinë që gjithsecili ka në brendësi të vetes.

Ashtu si Mateli, disenjatori i kukullave, shpresoj se kukulla mund të ndihmojë për të ndryshuar qëndrimet dhe stereotipet rreth personave me aftesi te kufizuar dhe mund të ndihmojë femijet me aftesi te kufizuar të ndërtojnë vetë-vlerësimin e tyre.

SI TË GATUAJME RECETA TË REJA

Ftonj të zjerë me pekmez

Normativa:

- Pekmez 1 kg
- Ftonj në thela 2 kokra
- Gjalp l tretur 1 lugë
- Indërsha ose borzilok i thatë
- Pak aromë

Historiku i gatesës së ëmbëlsirës thela ftoi me pekmes është e hershme, është zajre dimri (rezerva ushqimore).

Pikërisht me këtë fillon gatesa dhe shijohet ditën e parë të dimrit datë 26 tetor ditën e Shën Dhimitrit ku përcaktohet dita e parë e dimrit; shtroheshin teshat e trasha si postiqe valencate dhe ndizej zjarri e si për mbarësi vihej në zjarr tava me pekmes e mbasi merte valë shtoheshin thela ftori të qëruar kështu shtëpia kish mbarësi e dimri bëhej më l butë sipas gojdhënave, po këtë ditë meshkujt mbasi hanin mengjesin dhe ëmbëlsoheshin me këte gatesë , fillonin vjeljen e ullinjëve ku ish edhe dita e parë e vjeljes.

Përgatitja:

Në një tenxhere hedhim pekmezin dhe e vendosim në zjarr. Kur uji të ketë shterur dhe të jetë lëngëzuar shtojmë thelat e ftonjve të qëruar bashkë me gjalpin e tretur . l ziejmë në zjarr të avashëm për 30-40 minuta .

Mbasi të ketë zjerë shtojmë aromën. E ndajmë në racione dhe shërbehet e ngrohtë në vahtin e mëngjesit .

Katër stinët

Normativa:

- Domate 100 gr
- Sallata 100 gr
- Fasule e thatë 30 gr
- Ullinj 100 gr
- Vezë 1 kokër
- Salc kosi 40 gr
- Limona 20 gr
- Vaj ulliri 25 gr
- Qep 20 gr
- Sallat jeshile 50 gr
- Kripë; Piper

Përpunimi:

Kjo sallatë më lindi si ide që të bashkoja disa ngaperimet e gjith vitit, qto më kryesoret të cilat konsumatori do të shijoj n cdo stinë, dhe sot i gjen.

Unë gërshetova, harmonizova dhe pasqyrova një dekor të harmonishëm.

Lëndët përbërëse të kësaj pjatance me Sallatë janë: Domate , Sallator, Karotë , Fasule të zjera (boboli) të spikatura me krip e piper të zi, 1 vez e zjerë që vendoset mbi karotë dhe imiton kërpudhën, ullinj, limon, qep, majdanoz dhe një fletë sallat jeshile e cila vendoset poshtë pjatancës .



Shënim:

Dekori nuk është fik, ai varet nga dëshira apo fantasia e mjeshtrit që e ndërton. Dekori s' ka kufi, pasqyrimi i pjatancës është dhe sukcesi i atij që e shtron. Kjo sallat serviret për dy persona.

Zogj tave me rosnica

Normativa per 5 persona:

- Zogj mesatarë 5 copë
- Miell 500gr
- Vezë 5 kokrra
- Gjalpë 200gr
- Kripë, piper e nane



Pregatitja:

Skuqim zogjtë me gjalp, i hedhim kripë, piper, 1 litër ujë të nxehtë dhe i lemë të marrin një valë për 5 minuta. Përgatitja e rosnicave bëhet si më poshtë: Me miellin e situr, vezët dhe kripën përgatitet një brumë i fortë. Brumi thërmohet në sfera të vogla dhe skuqet me gjalpin e mbetur. Shtojmë lëngun e zogjve, i shtojmë në tepsitë bashku me zogjtë dhe i pjekim në furrë për 35-45 minuta. Shërbehen të nxehtë duke u pudrosur me nane të imët.

Josif Mio

Shef kuzhine, person me aftësi të kufizuar në të shikuar, Berat

MJALTI DHE DOBITË E TIJ

- Mjalti kalon menjëher në gjak.
- Ai është një ushqim i domosdoshëm për ata që vuajn nga anemia.
- Mjalti është shumë i lehtë për stomakun.
- Ai është shumë i pasur me vitamina B,B6 dhe C.
- Ndhmon në rritjen e shëndoshë të fëmijëve.
- Mjalti pastron gjakun.
- Mjalti është miku i zemrës dhe i atyre që vuajnë nga ulcra e stomakut.

- Mjalti ndikon në zhvillimin e kockave.
- Mjalti ndikon në uljen e tensionit të gjakut.
- Mjalti normalizon frymarjen.
- Mjalti forcon intelektin e njeriut .
- Bënë mirë për reumatizmen.
- Mënjanton dhimbjen në ato vende që lyhen me të .
- Kur përdoret së bashku me ujë të ftohtë është ilac i mirë kundër kapsëllëkut